



Bazuar në nenin 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, nenet 4 dhe 8 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Vendimit Nr. DE 861/2026, Agjencia Kosovare e Privatizimit, më datë 01/06/2026, publikon këtë:

### NJOFTIM PËR ANULIM

Agjencia Kosovare e Privatizimit, më datë 18/04/2026, ka shpallur procedurat e rekrutimit për katër pozita: "Udhëheqës i Ekipit të Privatizimit/ ZR Prishtinë"; "Udhëheqës i Ekipit të Privatizimit/ ZR Pejë"; "Udhëheqës i Ekipit të Likuidimit / ZR Prishtinë"; si dhe "Zyrtar i Lartë për Transaksione të Likuidimit".

Pas shpalljes së procedurave të rekrutimit, nëpunësit e mbetur në listë të pritjes kanë shfaqur interesim për t'u trajtuar për ri sistemim edhe në pozita me nivel/kategori më të ulët se pozitat e tyre paraprake. Kjo paraqet rrethanë të re faktike dhe procedurale, e cila ka krijuar nevojën që pozitat e shpallura të rishqyrtohen fillimisht në kuadër të mundësisë së plotësimin të tyre përmes ri sistemimit të brendshëm.

Në këtë drejtim, duke marrë parasysh se pozitat e lira mund të trajtohen në kuadër të procesit të ri sistemimit të nëpunësve ekzistues nga lista e pritjes, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, si dhe ushtrimit të diskrecionit administrativ sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është vlerësuar se vazhdimi i procedurave të rekrutimit për pozitat përkatëse nuk paraqet më nevojë të domosdoshme institucionale.

Andaj, Agjencia Kosovare e Privatizimit njofton anulimin e procedurave të rekrutimit për pozitat si në vijim:

1. UDHËHEQËS I EKIPIT TË PRIVATIZIMIT / ZR PRISHTINË, me nr. ref. RN00019586;
2. UDHËHEQËS I EKIPIT TË PRIVATIZIMIT / ZR PEJË, me nr. ref. RN00019587;
3. UDHËHEQËS I EKIPIT TË LIKUIDIMIT / ZR PRISHTINË, me nr. ref. RN00019588;
4. ZYRTAR I LARTË PËR TRANSAKSIONE TË LIKUIDIMIT, me nr. ref. RN00019590.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me këtë njoftim për anulim mund të ushtrojnë ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në afatin ligjor prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Prishtinë, 01 qershor 2026.

Divizioni i Burimeve Njerëzore

Agjencia Kosovare e Privatizimit

